

Ligjëratë nga lënda:

Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci Moderne

Përmbledhje ligjërate VII

Organizatave ndërkombëtare dhe e drejta ndërkombëtare

- Tre faktorë ndikuan së bashku për të tronditur normat ndërkombëtare kohët e fundit: përfundimi i Luftës së Ftohtë (që ndryshoi mënyren e organizimit të fuqisë); ndryshimet në gjendjen ekonomike të rajoneve e të shteteve të ndryshme (siç janë Kina, SHBA në krahasim me Japoninë, Rusinë dhe Afrikën dhe ndikimet e ndryshimit teknologjik në krijimin e një “bote të vogël”.
- Sekretari i Përgjithshëm i atëhershëm i OKB-së, Kofi Anan, pas luftës së Kosovës së vitit 1999, tha se kombet nuk duhet të përdorin Kartën e OKB-së si mburojë për të kryer gjenocid dhe se të drejtat e njeriut marrin “përparësi mbi shqetësimet për sovranitetin shtetëror”.
- Anarkia ndërkombëtare baraspeshohet nga rendi botëror, dmth, nga rregullat e institucioneve nëpërmjet të cilave shtetet bashkëpunojnë për përfitime të ndërsjellta.
- Rendi botëror është mbështetur gjithnjë mbi fuqinë, por rendi bëhet ndërmjetës i fuqisë së verbër me anën e vendosjes së normave e zakoneve që drejtojnë ndërveprimet e shteteve.
- Shtetet i respektojnë shpesh rregullat, normat morale e ligjet zyrtare ndërkombëtare.
- “Rendi i ri ndërkombëtar” është një grup normash, të këshilluara nga ish-Presidenti Xhorxh Bush, për sjelljen ndërkombëtare në periudhën e Pasluftës së Ftohtë.
- Rregullat ndërkombëtare veprojnë nëpërmjet institucioneve (organizatave ndërkombëtare), kurse OKB-ja ndodhet në qendër të këtij rrjeti institucional.
- OKB-ja mishëron fërkimet ndërmjet sovranitetit shtetëror dhe autoritetit mbikombëtar. Në Kartën e historinë e saj, OKB-ja e ka bërë sovranitetin, parimin më të rëndësishëm. Kjo gjë e ka kufizuar fuqinë e OKB-së.
- OKB-ja në mënyrë të veçantë i hap rrugë sovranitetit të fuqive të mëdha, pesë prej të cilave si anëtare të përherëshme të Këshillit të Sigurimit mund të bllokojnë secila çdo resolute që lidhet me sigurimin që është e detyrueshme për shtetet anëtare të OKB-së.
- Pjesërisht për shkak të respektit ndaj sovranitetit shtetëror, OKB-ja ka tërhequr pothuajse një anëtarësi të gjithë shteteve të botës, ku përfshihen të gjitha fuqitë e mëdha.
- Secili prej 192 shteteve anëtare të OKB-së ka një vote në Asamblenë e Përgjithëshme, e cila shërben kryesisht si forum botëror dhe si organizatë çadër për përpjekjet për zhvillim shoqëror e ekonomik të botës së tretë.
- Këshilli i Sigurimit ka dhjetë shtete anëtarë që ndryshojnë me rotacion dhe pesë anëtarë të përhershëm: SHBA, Rusia, Kina, Britania e Franca.
- OKB-ja administrohet nga nëpunës civil ndërkombëtar të Sekretariatit, i cili drejtohet nga sekretari i përgjithshëm.
- Buxheti i rregullt i OKB-së së bashku me të gjitha veprimtaritë paqëruajtëse arrin një shumë e cila është shumë më pak se sa 1 përqind e asaj që bota shpenzon për forcat ushtarake.

- Modelet e votimit dhe koalicionet në OKB kanë ndryshuar me kalimin e viteve, së bashku me zgjerimin e anëtarësisë dhe ndryshimin e rrethanave. Tani, roli i SHBA-së është i fortë por kontradiktor, sepse SHBA ka kërkuar reformimin e OKB-së, por nuk ka paguar më shumë se një miliard USD që i detyrohet asaj.
- Paqëruajtësit e OKB-së veprojnë nën komandën e flamurin e OKB-së. Ndonjëherë, trupat kombëtare veprojnë me flamurin e komandën e tyre për të zbatuar rezolutat e OKB-së (si në koalicionin shumëkombësh të udhëhequr nga SHBA në Luftën e Gjirit).
- Ish-Sekretari i Përgjithshëm Boutros-Ghali hodhi idenë e fuqizimit të forcave ushtarake të OKB-së për të krijuar njësi të armatosura rëndë për arritjen e paqës, që mund të kundërpërgjigjeshin më shpejtë ndaj shpërthimit të konflikteve. Fuqitë e mëdha e hodhën poshtë këtë ide.
- Organizatat ndërqeveritare përfshijnë programet e OKB-së (kryesisht për çështje ekonomike e shoqërore), agjencitë autonome të OKB-së e organizatat që nuk kanë lidhje zyrtare me OKB. Ky rrjet institucional ndihmon për të forcuar e bërë më të qëndrueshme rregullat e MN.
- E drejta ndërkombëtare, grupi zyrtar i rregullave të marrëdhënieve shtetërore, rrjedh prej traktateve, zakoneve, parimeve të përgjithëshme dhe dijes ligjore, jo prej legjislacionit që miratohet nga çdo shtet.
- E drejta është e vështirë për t'u zbatuar dhe në praktikë zbatohet nëpërmjet pushtetit kombëtar, koalicioneve ndërkombëtare dhe praktikës së ndërsjelltësisë.
- Gjykata Botërore gjykon ankesat e një shteti kundër një shteti tjetër, por nuk mund të shkel sovranitetin shtetëror në pjesën më të madhe të rasteve. Kjo është një rrugë gjithnjë e më e dobishme për gjykimin e konflikteve krahasimisht të vogla.
- Pjesa më e madhe e rasteve që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërkombëtare janë gjykuar në gjykata kombëtare, ku një shtet mund të kërkoj zbatimin e gjykimeve brenda territorit të vet.
- Në të drejtën ndërkombëtare të drejtat e diplomatëve kanë pasur që prej një kohe të gjatë status të veçantë. Ambasadat vështrohen si pjesë të territorit të vendit të cilit i përkasin.
- Ligjet e luftës, janë të vendosura prej një kohe të gjatë e të përcaktuara mire. Ato bëjnë dallimin ndërmjet ushtarakëve dhe civilëve, duke i dhënë secilit prej tyre të drejta e përgjegjësi. Luftërat guerile dhe konfliktet etnike e kanë bërë më të paqartë këtë dallim.
- Luftërat aggressive shkelin normat e luftës së drejtë, që është ajo e cila kryhet për të zbrapsur ose ndëshkuar agresionin.. Ndonjëherë (por jo gjithnjë), është vështirë të dallosh se cili është agresori në një konflikt të dhunshëm ndërkombëtar.
- Normat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut pësojnë forcohen e po pranohen më gjërësisht. Megjithatë, ligji për të drejtat e njeriut është problematik, sepse ai sjell ndërhyrjen e një shteti në punët e brendshme të një shteti tjetër.